VENDIM
Nr. 451, datë 26.7.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI, REHABILITIMI DHE MIRËMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMI I SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT", NË FSHATIN ZENISHT, BASHKIA MAT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit", në fshatin Zenisht, Bashkia Mat.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Mat.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë "tokë truall", me sipërfaqe 10 100 m^2, me vlerë të përgjithshme 1 151 400 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 151 400 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Mat, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Mat.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë Mat, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.

8. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e pronësisë pranë Bashkisë Mat.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Mat, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Mat dhe Bashkia Mat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PRONAVE DHE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "PËR NDËRTIMIN, REHABILITIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE, SI DHE GARANTIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK TË VARRIMIT", NË FSHATIN ZENISHT, BASHKIA MAT

Nr.	**Emër, mbiemër**	**Nr. i pasurisë**	**Zona kadastrale**	**Sipërfaqja truall/m²**	**Çmimi/ lekë/m²**	**Vlera totale/lekë**	**Dokumenti i pronësisë**
1	Abaz Jakup Dobra	521/6	1319	10100	114	1 151 400	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	TOTALI					**1 151 400**	